



| | | | |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|---------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  Republika e Kosovës Republika Kosovo | ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA | |  Komuna e Istogut Opština Istok |
| | 02 Nr.134 /18 | Data: 01.08.2018 | |

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1. dhe 2. të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës Nr.03/L-212, Komuna e Istogut ,shpall:

K o n k u r s

Për kryerjen e punëve me kontratë për kohë të caktuar

Vendi i punës: Pastruese

Institucioni : Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)

Numri i referencës:

Paga mujore: 250 € në muaj

Kohëzgjatja e Emrimit : Me afat të caktuar - 1 (një) vit

Orari i plotë : 40 orë në javë

Detyrat :

- Të kujdeset për pastrimin e Objektivit të QKMF-së dhe objekteve tjera shëndetësore;
- T'i përgjigjet çdo ftese sipas nevojës të porositësit të shërbimeve për punë për në QKMF dhe sipas nevojë në Objektet tjera shëndetësore;
- Të njoftojë me kohë porositësin e shërbimeve për mungesën e paisjeve dhe materialit Higjieno-Sanitarë ;
- Si dhe shërbimet të tjera që rrjedhin nga natyra e punës së pastrueses.

Kushtet për punësim :

- Së paku të ketë të kryer shkollën fillore;
- Përparësi do të kenë personat që kanë përvojë pune si pastruese;
- Të mos jetë e ndjekur penalisht

Dokumentacioni i nevojshëm;

- Kopja e dokumentacionit të kualifikimit(diploma e shkollës fillore),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Çertifikata e lindjes apo ekstrakti i lindjes,
- Dy rekomandime,
- Dëshmi qe nuk jeni i ndjekur penalisht.

Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu qysh parashihet me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

Afati i aplikimit: Konkursi është i hapur pesëmbdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit: 01.08.2018 deri më datë : 15.08.2018

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Menaxheri i Personelit

Fatmir Bytyçi

